



qendra e provimeve

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI I MATURËS

GUSHT 2018

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike.

Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Testi **DUHET** të zhvillohet me laps kimik i cili nuk mund të fshihet.

Testi përmban detyra në të cilat do të përgjigjeni në njërën prej këtyre mënyrave:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes t'i përshkruash përgjigjet tuaja.

Detyra do të vlerësohet me (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë

Nëse gabon vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh zgjidhjen e testit, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tuaja. Me fat!

Me fat!



* A 8 9 9 3 6 *

FAQE E ZBRAZËT

Në bazë të tekstit përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Letër mbesës Katarinë

“Më kanë propozuar që të shkruaj një letër dhe unë e pranova, sepse kjo që dua të them ty ka të bëjë me të gjithë bashkëmoshatarët tu, përkatësisht me të gjithë ju që në vitin 2000 do të keni 20 vjet.

(...)

Kush e di çfarë do të bësh ti për njëzet vjet? Kush e di çfarë do të jesh? Kush e di nëse atëherë, sikurse edhe sot, do të jesh inteligjente, e butë, trimëreshë, krenare, e sinqertë, inventive, plot kuptim për humor? Shpresoj se do të jesh, por është e sigurt se bota do të bëjë gjithçka që të të ndihmojë që t’i humbësh ato veti të mira. Kundër tejet do të bashkohen fuqitë, dhe posaçërisht njëra – frika. Frika nga izolimi dhe kritika e shoqërisë, frika nga varfëria, frika nga mospjesëmarrja, nga obligimet dhe përgjegjësitë, nga lufta, nga vetmia, frika nga njerëzit, frika nga vdekja.

(...)

Tani nuk ke frikë nga asgjë, dhe kjo për mua është një kënaqësi e madhe. Në ty ende nuk vërej shenja të atyre frikave që vetëm të rriturit mund t’u vënë në krye fëmijëve. Më pëlqen të shikoj se si vetë fiton përvojë, si lëviz nëpër dhomë të errët, si i studion insektet dhe kafshët në natyrë, si përpiqesh ta përkëdhelësh qenin endacak ose t’u afrosh me një qetësi njerëzve të panjohur. Në këtë botë, ti dhe bashkëmoshatarët e tu jeni një ngushëllim i vërtetë. Sigurisht, shpresoj se ajo do të zgjasë përjetë, se gjithmonë do të jesh e tillë, fisnike dhe luftarake, e sigurt dhe e fuqishme, krenare dhe e përzemërt. Nëse do të kesh sukses në atë, do të gëzosh, sipas mendimit tim të gjitha kushtet që të zgjedhësh rrugën e drejtë.

(...)

Imagjinatës tënde dhe fantazisë së bashkëmoshatarëve tuaj në fakt nuk i shihet kufiri. Jeni të bindur në papërkulshmërinë tuaj, në gjithëfuqinë tuaj. Besoni se mund ta ndryshoni botën. E teproni. Por të rriturit ia teprojnë në kuptimin tjetër. Ata janë “praktik”, “konkret”. Do ta vësh: do të thonë që gjithmonë ka pasur të pasur dhe të varfër, se që moti ka pasur mjerim, prandaj edhe uri, privilegje, skllavëri, luftëra.

Janë krejtësisht të privuar nga imagjinata. Madje edhe shpresa.

Nëse edhe pas njëzet vjetësh do të kesh kreativitet dhe vetëbesim, me të cilët disponon sot, dhe nëse u përgjigjesh se me dëshirë, gjithçka mund të ndryshohet, posaçërisht pozita e njerëzve; nëse u përgjigjesh se duhet menduar për botën e cila përbëhet prej njerëzve, dhe jo prej pronarëve dhe shërbëtorëve; nëse u përgjigjesh ashtu, do të thonë se gjithë ajo është vetëm – një utopi.

(...)

Do të thonë se frika është një ndjenjë e cila e kaplon gjithkënd. Po, e saktë është ajo. Por frika nuk e shkatërron gjithkënd. Ty nuk do të shkatërrojë, për shembull, dhe jo

vetëm për shkak të paditurisë tënde fëmijërore, por për atë se je kthyer e tëra drejt sendeve dhe njerëzve që i do, pushtimeve dhe progresit, botës. Shkurtimisht, ti je jashtë dhe mbi personin tënd. Ata të cilët, edhe kur të rriten, mbesin të tillë janë shumë më të fuqishëm se çfarëdo frike.

Bëj nga ajo, kuptohet, vetëm atë që do të dëshirosh ti vetë.”

(Përgatitur sipas tekstit të Marcelo Bernardit – pediatrit dhe psikologut italian, të marrë nga <http://opusteno.rs/poucne-price-f152/poucna-prica-letër-katarinës-t31430.html>, 2 nëntor 2016)

1. Me të cilin qëllim autori i shkruan letër mbesës Katarinë?

1. Që t'i inkurajojë virtytet e saj dhe t'i tregojë për pengesat.
2. Që t'i tregojë për nevojën e domosdoshme të përshtatjes me botën e të rriturve.
3. Që mbesa ta mbajë në kujtesë edhe kur të rritet.

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

2. Shkruaj cilësitë e Katarinës.

1 pikë

3. Pranë qëndrimit të dhënë të të rinjve se bota mund të ndryshohet ceke edhe qëndrimin përkatës të të rriturve.

1 pikë

4. Përse fëmijët kur rriten humbin virtytet e veta? Duke u bazuar në tekst, argumento përgjigjen tënde.

1 pikë

5. Çfarë, sipas tekstit, luan rolin vendimtar për fitimin e vetëbesimit dhe pavarësimin të fëmijëve?

1. Pranimi pa kundërshtim i mendimit të të rriturve.
2. Shmangia e situatave të pamjaftueshme të njohura.
3. Fitimi i përvojës në mënyrë të pavarur.

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

Duke shfrytëzuar tekstin zhvillo detyrat 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Ivo Andriq

PËR DOSTOJEVSKIN

“Dostojevski është shkrimtar i cili ndër të parët në letërsinë botërore ka lënë peizazh, veshmbathjet e heronjve të vet, pamjen e tyre fizike, kohën madje edhe hapësirën, në mënyrë që deri në fund të mund t'i përkushtohet shpirtit të njeriut. Ai, pa dyshim, ka bërë një kthesë të fuqishme në fjalën e shkruar, si askush para tij dhe pak kush pas tij, ka bërë ndikim të fuqishëm jo vetëm në disa shkrimtarë por edhe në gati të gjitha letërsitë kombëtare në botë.

Për mua Fjodor Mihajloviç Dostojevski dhe Tomas Man janë dy figurat më madhore të letërsisë në mes të shekullit nëntëmbëdhjetë dhe njëzet; me ta ka filluar letërsia e re evropiane. Unë – sikurse edhe të gjithë shkrimtarët e brezit tim – i kam lexuar dhe studiuar veprat e këtij shkrimtarit...është e vërtetë se nën ndikimin e Dostojevskit dhe Manit jam frymëzuar me peizazhin dhe i kam dhënë një shtysë, duke e përshkruar në atë masë sa është e nevojshme që të kuptohet fati i njeriut dhe veprimit të tij... Të gjitha veprat e Dostojevskit janë njësoj të bukura dhe kanë një peshë të barabartë artistike. Ndoshta do të jem i padrejtë ndaj vetvetes, dhe më i padrejtë ndaj shkrimtarit të madh rus, nëse them se më së tepërmi më kanë prekur *Shënimet nga shtëpia e vdekur*. Në rini jam dridhur mbi *Shpirtrat e të së keqes të Dostojevskit*.”

(F.M. Dostojevski Vëllezërit Karamazov, Veselin Maslesha, Sarajevë, 1988; Përzgjedhje nga kritikant, faqe 512)

6. Kush është autor i tekstit?

1 pikë

7. Teksti është një fragment nga:

1. biografia
2. ditari
3. kritika

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

8. Motivi qendror në veprat e Dostojevskit është:

1. koha
2. shpirti i njeriut
3. pamja fizike e personazheve

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

9. Nën ndikimin e cilëve shkrimtarë Andriqi është frymëzuar dhe i ka dhënë një shtysë peizazhit?

1 pikë

10. Në tekst përmenden veprat *Shënimet nga shtëpia e vdekur* dhe *Shpirtrat e të së keqes*. Përse?

1 pikë

11. Nga teksti përshkruaj dy fjalë të cilat janë homonime.

“S’e marr vesh ç’do ti? – Verë! – Për verë shko tek Stavri, se ai e ka të Nartës. – Jo dua verë tjetër, të mos bjerë shi. Epo, pa shi s’bëhet rrushi, e pa rrush s’ ka verë. Jo unë them se pa verë s’ka rrush. Vera e pjek rrushin. Të vij vera sa më parë”.

1 pikë

12. Cakto rasën e emrave të nënvizuar nga fjalitë e dhëna.

Shëtitja të bën mirë. Barbanës fare nuk i këndohej. Qyteti i Ulqinit është turistik. Qëndresën e zgjodhën nxënësen më të mire. Kur erdha ai nuk ishte më te gardhi duke më pritur.

shëtitja _____

Barbanës _____

Ulqinit _____

Qëndresën _____

gardhi _____

1 pikë

- 13.** Formën rasore gardhi (...nuk ishte më te gardhi...) zëvendësoje me formën e sinonimit përkatës të rasës së përdorur?

1 pikë

- 14.** Rretho numrin para grupit të fjalëve që është njësi frazeologjike dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. nuk ia bën syri terr
2. rri pa lëvizur
3. në kohën e vet

1 pikë

- 15.** Cili ndryshim fonetik është përdorur në fjalën natë – net? Shpjego ndryshimin.

2 pikë

- 16.** Shkruaj saktë shkurtesat e fjalëve:

Qendra Klinike Spitalore e Malit të Zi _____

magjistër _____

e tjerë _____

për shembull _____

2 pikë

- 17.** A) Nënvizohet foljen joveprore në mënyrën habitore në fjali.

Ai qenkësh mësuar me këtë lloj jete.

1 pikë

- B) Në cilën vetë është përdorur?

1 pikë

Pyetjet në vazhdim kanë të bëjnë me veprën *Juda Makabe* dhe fragmentet nga ajo vepër. Kujto zhvillimin dhe personazhet e veprës dhe lexo fragmentet e cituara pastaj zhvillo detyrat 18, 19, 20 dhe 21.

Juda
Un gati kam treqind.
Atherë, me çeta t'mia
Do prita sa t'i za,
M'anmik ti ke me ra
Me sa mund t'mbledhish gjind.
Mandej, edh'un me 'i hera
Po vi me do shokë të mi.

Prifti
Njëmend, si thue, Zotni,
A e shkrefim luftën sot?
Po mbledhim do ushtri tjera,
E, mbasi t'jem' forcue,
M'anmik prap kem' me u lshue
Me ndihmë të madhit Zot.

- 18.** Shkruaj emrin dhe mbiemrin e autorit të veprës letrare nga e cila janë shkëputur vargjet e dhëna.

1 pikë

- 19.** A) Cilit lloj të gjinisë dramatike i përket vepra në fjalë?

1 pikë

- B) Nga cila vepër është marrë subjekti i saj?

1 pikë

20. Kujt ia vë në gojë fjalët e mëposhtme autori.

Perëndi a ndjeve?
Tradhtarët na lanë pa Atdhe,
E Ti rri e gjuan m'rrufe
Lisat n'për male kot.

1 pikë

21. Cili personazh është në qendër të veprës dhe mbi çka është ndërtuar konflikti i saj?

2 pikë

Lexo vargjet në vazhdim dhe zhvillo detyrat 22, 23 dhe 24.

1. Porsi luani, e ngrit zërin e tij të trishtuar.
Porsi luanesha e qëlluar me shtizë, ulërin ai.
Flokët i shkul i hedh.
Teshat i shqyen.
Petkun e zisë e vesh, të pluhurosur

2. Fati i mikut aq vështirë qëndron mbi mua,
prandaj vajtoj nëpër fusha
dhe kërkoj lugina.
Si mund ta hesht atë,
Si ta shpreh pikëllimin?
Mikun që e dua u bë dhe.
Miku im, Enkiduji,
sikurse baltë toke ai u bë!
A nuk duhet të qetësohem ashtu si ai
dhe të mos ngrihem sa të jetë jeta?

(Epi i Gilgameshit)

22. Cili motiv theksohet në vargjet e dhëna?

1. motivi i vdekjes
2. motivi i dashurisë dhe miqësisë
3. motivi i krijimit të njeriut të parë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

23. Rretho numrin para fjalës onomatopeike në pjesën e parë të vargjeve të dhëna dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. trishtuar
2. ulërin
3. shkul
4. pluhurosur

1 pikë

24. Përse pajtohet vështirë Gilgameshi me vdekjen e Enkidujit?

2 pikë

25. Lidh me vija emrat e personazheve letrare me titujt e veprave letrare (një vepër është e tepërt).

Gjon Zaveri	Plaku dhe deti
Jozef K.	Nga jeta në jetë-pse
Santiago	Procesi
Gori Gjinleka	Kolonelit s' kishte kush t'i shkruajë
	Hasta la vista

2 pikë

26. Dallo epokën letrare të cilës i përkasin autorët e dhënë.

Homeri, Sofokliu, Virgjili, Sapfa

1 pikë

Lexo vargjet e mëposhtme dhe zhvillo detyrat 27 dhe 28.

Rini, thueja kangës ma të bukur që di!
Thueja kangës sate që të vlon në gji.
Nxirre gëzimin tand' të shpërthejë me vrull...
Mos e freno kangën! Le të marri udhë.

Thueja kangës, rini, pash syt e tu...
Të rroki, të puthi kanga, të nxisi me dashnu
me zjarm tand, rini... Dhe të na mbysi dallga
prej ndjenjash të shkumbzue me q'i turbullon kanga.

Rini, thueja kangës dhe qeshu si fëmi
Kumbi i zanit të përplaset për qiellë
dhe të kthejë prap te na, se hyjt ta kanë zili

e na të duem fort si të duem një diell.
Thueja kangës, Rini! Thueja kangës gëzimplotë!
Qeshu, rini! Qeshu! Bota asht e jote.

27. Shkruaj titullin e përmbledhjes ku bën pjesë poezia, autorin e saj dhe titullin e vjershës.

Titulli i përmbledhjes _____

Autori _____

Titulli i vjershës _____

3 pikë

28. Çfarë përshkruan poeti në vargjet e dhëna.

2 pikë

29. Lexo fragmentin e dhënë pastaj përgjigju në pyetjen në vazhdim.

Njeri i ndershëm, thash me veten, është një trillim dhe përfytyrim që nuk mund të qëndrojë në botën e hajdutëve dhe në kohë. Është i pafat, i paaftë, gjithkund, të gjithë ia bëjnë me hile, humb çdo lojë dhe humb kokën, çdo maskara e përqesh. Nëse është i ndershëm – nuk është një njeri por vetëm një gjysmë, dhe nuk është tamam e sigurt se është gjysma më e mirë. Madje edhe nëse do të ishte më e mirë, a do t'i ndihmonte ajo diçka?

A) Rrëfimi në këtë fragment rrjedh në:

1. vetën e parë
2. vetën e dytë
3. vetën e tretë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

B) Nga teksti përshkruaj një dëshmi për përgjigjen nën A.

1 pikë

30. Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rrethoje numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEË FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Gjatë hartimit të esesë kij kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. Shkruaj lexueshëm.

1. Iluzionet e të riut Rastinjak (*Xha Gorio*)

Me kujdes lexo udhëzimet për shkrimin e esesë.

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Shkruaj për temën dhe drejtimin letrar të cilit i përket romani.
- Ceki të paktën dy personazhe të veprës (përveç Rastinjakut) dhe shkurtimisht përshkruaji ata.

- Përshkruaje Ezhen de Rastinjakun (prej ka vjen dhe me cilin qëllim vjen).
- Përshkruaj vështrimet e tij të para për shoqërinë franceze.
- Sqaro para çfarë dilemash është vendosur Rastinjak në rrugën e tij drejt përparimit në shkallën shoqërore (ceke çfarë zgjedh dhe përse e bën këtë, përshkruaje çfarë sjelljeje ka, për çfarë mendon).
- Si përfundim përcaktoju për një nga qëndrimet e ofruara dhe argumento zgjedhjen: Ezhen është viktimë e normave shoqërore/ Ezheni është njeri i cili përshtatet.

2. Arti i filmit dikur dhe sot

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Numëro zhanret e artit të filmit.

Veço zhanrin të cilin e do më së shumti.
- Çfarë domethënie ka arti i filmit në të kaluarën? Çfarë është rëndësia e tij sot, përkatësisht në kohën e zhvillimit të teknologjisë dhe rrjeteve shoqërore.
- A pajtohesh me mendimet e shumta se filmi sot është përplot me skena të dhunshme? Argumento qëndrimin tënd.
- Komento qëndrimin e regjisorit të njohur Stenli Kjubrik në një intervistë që skenat e dhunshme nëpër filma nuk mund të nxisin dhunën.
- Në formë të përfundimit jepe qëndrimin tënd për ndikimin e filmit tek të rinjtë.

25 pikë



1.

2.

3.

4.

5.

6.

7.

8.

9.

10.

11.

12.

13.

14.

15.

1.
2.
3.
4.
5.
6.
7.
8.
9.
10.
11.
12.
13.
14.
15.
16.
17.
18.

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9
10 11 12 13 14 15 16 17 18 19